

LIGJ
Nr. 77/2024

**PËR MIRATIMIN E REZOLUTËS NR. 265, “RRITJA E FONDIT TË KAPITALIT
TË AUTORIZUAR DHE REGJISTRIMI/NËNSHKRIMI NË TË”, TË VITIT 2023, TË
BORDIT TË GUVERNATORËVE TË BANKËS EVROPIANE PËR RINDËRTIM
DHE ZHVILLIM (BERZH)**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Miratohet rezoluta nr. 265, “Rritja e fondit të kapitalit të autorizuar dhe regjistrimi/nënshtkrimi në të”, të vitit 2023, të Bordit të Guvernatorëve të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH).

Neni 2

Autoriteti kompetent për realizimin e rritjes së përgjithshme të kapitalit të Republikës së Shqipërisë në Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) (në vijim “Banka”) është ministria përgjegjëse për financat.

Neni 3

Ministria përgjegjëse për financat autorizohet të komunikojë me Bankën për përcaktimin e dokumentacionit dhe mënyrën e kryerjes së pagesës.

Neni 4

Ministria përgjegjëse për financat plotëson dokumentacionin e kërkuar nga Banka dhe kryen pagesën në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Neni 5

Ministri përgjegjës për drejtësinë, si pjesë e dokumentacionit të kërkuar nga Banka, lëshon një dokument të titulluar “Memorandum i ligjit” për të konfirmuar se janë ndërmarrë të gjithë hapat ligjorë për të përmbushur detyrimet që burojnë nga rritja e kapitalit.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 26.7.2024

**Shpallur me dekretin nr. 277, datë 31.7.2024, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bajram Begaj.**

ANEKS A
REZOLUTA NR. 265
RRITJE E FONDIT TË KAPITALIT TË AUTORIZUAR DHE
REGJISTRIMI/NËNSHKRIMI NË TË

BORDI I GUVERNATORËVE:

Duke rikonfirmuar angazhimin e aksionerëve për të mbështetur Ukrainën si reagim ndaj pushtimit ushtarak nga Federata Ruse;

Duke rikujtuar rezolutën nr. 258 “Mbështetja e BERZH-it për qëndrueshmërinë dhe rindërtimin në Ukrainë: rruga për të ecur përpara”, me anë të së cilës Bordit të Drejtorëve i bëhet thirrje të paraqesë një propozim konkret mbi objektin e mbështetjes së Bankës për Ukrainën dhe një rritje të mundshme të kapitalit të paguar;

Duke shqyrtuar me kujdes raportin e Bordit të Drejtorëve “Propozimi për një rritje të kapitalit të paguar” (“Raporti”);

Duke miratuar objektin e parashikuar për Bankën në bashkëpunim me partnerë të tjerë të Ukrainës dhe si pjesë e një përpjekjeje të mirëkoordinuar ndërkombëtare për të mbështetur Ukrainën, duke ruajtur dhe zbatuar mandatin unik të Bankës dhe modelin e biznesit;

Duke theksuar rëndësinë që ka roli i Bankës për vazhdimin e mbështetjes për të gjitha vendet e saj të operacioneve në trajtimin e sfidave më urgjente të tranzicionit, në përputhje me drejtimin strategjik të Bankës;

Duke rënë dakord se kërkohet një rritje e paguar në fondin e kapitalit të autorizuar të Bankës për t’i mundësuar të luajë rolin e saj në Ukrainë, duke vazhduar të mbështesë plotësisht të gjitha vendet e saj të operacioneve;

Duke mirëpritur dhe miratuar ambiciet specifike të Bankës për punën e saj në Ukrainë, si dhe angazhimet afatshkurtra dhe afatgjata për evoluimin e vazhdueshëm të Bankës, siç shtjelohet në Raport; dhe

Duke theksuar angazhimin e Bankës për përdorimin efikas të burimeve të saj kapitale dhe zbatimin e vazhdueshëm të rekomandimeve të rishikimit të Kornizës së Mjaftueshmërisë së Kapitalit të G20, siç shtjelohet në Raport.

VENDOS SI MË POSHTË:

1. Rritja e fondit të kapitalit të autorizuar

Fondi i kapitalit të autorizuar të Bankës, në fuqi më 31 dhjetor 2024 (“data e hyrjes në fuqi”), do të rritet me 400,000 aksione të paguara. Çdo aksion ka një vlerë nominale prej 10,000 eurosh.

2. Regjistrimet/nënshkrimet

a) Në përputhje me nenin 5.3 të Marrëveshjes për Themelimin e Bankës (“Marrëveshja”), çdo anëtar në datën e miratimit të kësaj rezolute do të ketë të drejtë të regjistrojë/nënshkruajë, në vlerë nominale, në një raport të rritjes së fondit ekuivalent me raportin që fondi i nënshkruar mban ndaj fondit total të kapitalit të nënshkruar të mbajtur nga Banka menjëherë para datës së miratimit të kësaj rezolute, në rend zbritës në pjesën më të afërt. Çdo regjistrim/nënshkrim i tillë do të jetë sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në këtë rezolutë.

b) Më ose para datës 30 qershor 2025, ose në një datë tjetër vijuese jo më vonë se data 31 dhjetor 2025 siç mund të përcaktojë Bordi i Drejtorëve në ose para datës 30 qershor 2025, çdo anëtar që dëshiron të nënshkruajë/regjistrojë në bazë të kësaj rezolute, do të depozitojë në Bankë dokumentet e mëposhtme në një formë të pranueshme për Bankën:

i. një instrument regjistrimi/nënshkrimi ku anëtari regjistron/nënshkruan numrin e aksioneve të paguara, të specifikuara në këtë instrument;

ii. një përfaqësim që anëtari ka ndërmarrë sipas rregullave, të gjitha veprimet legjislative dhe veprimet e tjera të brendshme të nevojshme për t’i mundësuar atij që të bëjë një regjistrim/nënshkrim të tillë; dhe

iii. një angazhim që anëtari do të japë informacionin që Banka mund të kërkojë në lidhje me një veprim të tillë.

c) Çdo instrument regjistrimi/nënshkrimi do të hyjë në fuqi dhe regjistrimi/nënshkrimi sipas tij do të konsiderohet se është bërë në datën e hyrjes në fuqi, ose në datën kur Banka njofton anëtarin nënshkrues se dokumentet e depozituara nga ky anëtar në përputhje me paragrafin (b) më sipër, janë të pranueshme për Bankën, cilado qoftë më e vonshme.

d) Aksionet e autorizuar nga kjo Rezolutë, të cilat nuk do të jenë regjistruar/nënshkruar në përputhje me këtë Rezolutë deri në kohën kur ka skaduar afati për regjistrimin/nënshkrimin, do të mbahen nga Banka dhe do të rezervohen për regjistrimet/nënshkrimet fillestare nga anëtarët e rinj dhe për rritje të veçanta në regjistrimet/nënshkrimet e anëtarëve individualë, siç mund të përcaktohet nga Bordi i Guvernatorëve në përputhje me nenet 5.2 dhe 5.4 të Marrëveshjes.

e) Më 1 maj 2033, çdo aksion i regjistruar/nënshkruar në përputhje me këtë Rezolutë që nuk është paguar, pavarësisht nga zbatimi i kushteve të pagesës më poshtë, do t'i dorëzohet automatikisht Bankës pa asnjë kundërvlerë, me aksionet e anëtarit(ve) përkatës të reduktuar sipas rastit. Çdo aksion i tillë i dorëzuar do të mbahet gjithashtu nga Banka dhe do të rezervohet për regjistrimet/nënshkrimet fillestare nga anëtarët e rinj dhe për rritje të veçanta në regjistrimet/nënshkrimet e anëtarëve individualë, siç mund të përcaktohet nga Bordi i Guvernatorëve në përputhje me nenet 5.2 dhe 5.4 të Marrëveshjes.

3. Kushtet e pagesës

a) Pagesa për aksionet e paguara të nënshkruara në përputhje me këtë Rezolutë, do të bëhet në pesë kështe të barabarta vjetore. Kësti i parë do të paguhet nga secili anëtar deri: (i) më 30 prill 2025; ose (ii) 60 ditë pasi instrumenti i tij i regjistrimit/nënshkrimit të ketë hyrë në fuqi. Katër kështe e mbetura do të paguhet deri përkatësisht më 30 prill 2026; 30 prill 2027; 30 prill 2028 dhe 30 prill 2029. Një anëtar, pas konsultimit me Bankën, mund të kryejë pagesa me kushte më të favorshme për Bankën sesa ato të parashikuara në dispozitat e mësipërme të këtij paragrafi. Një anëtar mund të përmbushë të gjitha ose një pjesë të detyrimeve të tij të pagesës në nota premtuese të panegociueshme, pa interes, të arkëtueshme nga Banka me vlerën nominale sipas kërkesës, në një skedul të përafëruar me datat e fundit të kështeve të mësipërme.

b) Të gjitha detyrimet e pagesës së një anëtarit në lidhje me regjistrimin/nënshkrimin ndaj aksioneve në përputhje me këtë rezolutë, do të shlyhen në euro (EURO), në dollarë të Shteteve të Bashkuara (USD); ose në jen japonez (JPY), në dy rastet e fundit në bazë të kursit mesatar të këmbimit në valutën përkatëse për sa i përket valutës Euro për periudhën nga data 1 korrik 2023 deri më 30 shtator 2023, duke përfshirë këtu, të kuotuar nga Banka Qendrore Evropiane, specifikisht 1 EURO: 1,0844 USD dhe 1 EURO: 157,25 JPY. Anëtarët që dëshirojnë të shlyejnë detyrimet e tyre të pagesës në dollarë të Shteteve të Bashkuara ose në jen japonez, do të bëjnë një zgjedhje të pakthyeshme për këtë efekt si pjesë e instrumentit të tyre të regjistrimit/nënshkrimit, të zbatueshme për të gjitha pagesat.

(Miratuar më 15 dhjetor 2023.)

RESOLUTION NO. 265

INCREASE IN AUTHORISED CAPITAL STOCK AND SUBSCRIPTIONS THERETO

THE BOARD OF GOVERNORS:

Reaffirming the commitment of shareholders to support Ukraine in response to the military invasion by the Russian Federation;

Recalling Resolution No. 258 *‘EBRD’s Support for Resilience and Reconstruction in Ukraine: The Way Forward’* calling on the Board of Directors to submit a concrete proposal on the scope of the Bank’s support for Ukraine and a potential paid-in capital increase;

Having carefully considered the Report of the Board of Directors *‘Proposal for a Paid-in Capital Increase’* (the ‘Report’);

Endorsing the scope envisaged for the Bank in collaboration with other partners of Ukraine and as part of a well-coordinated international effort to support Ukraine, maintaining and applying the Bank’s unique mandate and business model;

Stressing the importance of the Bank’s role in continuing to support all of its countries of operations in addressing the most pressing transition challenges, aligned with the Bank’s strategic direction;

Being in agreement that a paid-in increase to the Bank’s authorised capital stock is required to enable it to play its role in Ukraine while continuing to fully support all of its countries of operations;

Welcoming and endorsing the Bank’s specific ambitions for its work in Ukraine, as well as the short- and long-term commitments for the Bank’s continuing evolution, as elaborated in the Report; and

Noting the Bank’s commitment to the efficient use of its capital resources and the continuing implementation of the G20 Capital Adequacy Framework review recommendations, as elaborated in the Report.

HEREBY RESOLVES THAT:

1. Increase in Authorised Capital Stock

The authorised capital stock of the Bank shall, effective on 31 December 2024 (the “Effective Date”), be increased by 400,000 paid-in shares, each share having a par value of EUR 10,000.

2. Subscriptions

(a) In accordance with Article 5.3 of the Agreement Establishing the Bank (the ‘Agreement’), each member as at the date this Resolution is adopted shall be entitled to subscribe, at par, to a proportion of the increase in stock equivalent to the proportion which

its stock subscribed bears to the total subscribed capital stock held by the Bank immediately prior to the date this Resolution is adopted rounded downwards to the nearest share. Each such subscription shall be on the terms and conditions set forth in this Resolution.

(b) On or before 30 June 2025, or such subsequent date not later than 31 December 2025 as the Board of Directors may determine on or before 30 June 2025, each member wishing to subscribe pursuant to this Resolution shall deposit with the Bank the following documents in a form acceptable to the Bank:

- (i) an instrument of subscription whereby the member subscribes to the number of paid-in shares specified in such instrument;
- (ii) a representation that the member has duly taken all legislative and other internal action necessary to enable it to make such subscription; and
- (iii) an undertaking that the member will furnish such information as the Bank may request concerning such action.

(c) Each instrument of subscription shall become effective and the subscription thereunder shall be deemed to have been made on the Effective Date, or on the date on which the Bank notifies the subscribing member that the documents deposited by such member pursuant to paragraph (b) above are satisfactory to the Bank, whichever is the later.

(d) The shares authorised by this Resolution which shall not have been subscribed to in accordance with this Resolution by the time that the deadline for subscription has expired shall be retained by the Bank and reserved for initial subscriptions by new members and for special increases in the subscriptions of individual members, as may be determined by the Board of Governors pursuant to Articles 5.2 and 5.4 of the Agreement.

(e) On 1 May 2033, any shares subscribed to pursuant to this Resolution that have not been paid for, notwithstanding the application of the payment terms below, shall automatically be surrendered to the Bank at no consideration, with the shareholding of the relevant member(s) reduced accordingly. Any such surrendered shares shall also be retained by the Bank and reserved for initial subscriptions by new members and for special increases in the subscriptions of individual members, as may be determined by the Board of Governors pursuant to Articles 5.2 and 5.4 of the Agreement.

3. Payment Terms

(a) Payment for the paid-in shares subscribed pursuant to this Resolution shall be made in five equal annual instalments. The first instalment shall be paid by each member by the later of (i) 30 April 2025; or (ii) 60 days after its instrument of subscription has become effective. The remaining four instalments shall be paid by 30 April 2026; 30 April 2027; 30 April 2028 and 30 April 2029, respectively. A member may, after consultation with the Bank, make payments on terms more favourable to the Bank than those stipulated in the foregoing provisions of this paragraph. A member may satisfy all or part of its payment obligations in non-negotiable, non-interest-bearing promissory notes, encashable by the Bank at par value upon demand on a schedule aligned with the foregoing instalment due dates.

(b) All payment obligations of a member in respect of subscription to shares in accordance with this Resolution shall be settled in Euro (EUR), in United States Dollars (USD) or in Japanese Yen (JPY), in the latter two cases on the basis of the average exchange rate of the

relevant currency in terms of Euro for the period from 1 July 2023 to 30 September 2023, inclusive, quoted by the European Central Bank, specifically 1 EUR : 1.0844 USD and 1 EUR : 157.25 JPY. Members wishing to settle their payment obligations in United States Dollars or in Japanese Yen shall make an irrevocable election to such effect as part of their instrument of subscription, applicable to all payments.

(Adopted 15 December 2023)